FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2018 – Numri: 143

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 9 tetor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 29.9.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosura", të ndryshuar.....	9593
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 556, datë 29.9.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 60, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018, në njësitë e qeverisjes qendrore", të ndryshuar.....	9595
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 29.9.2018	Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga qendra e shërbimeve arsimore.....	9595
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 29.9.2018	Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare	9597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 562, datë 29.9.2018	Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë.....	9598

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 29.9.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 203, datë 16.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, të pronës nr. 186, me emërtim "Reparti Ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore", me vendndodhje në Sauk, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar".....	9598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 29.9.2018	Për dhurimin UNESCO-s të ikonës "Ngjallja e Llazarit", në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë.....	9599
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 29.9.2018	Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.....	9600
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 29.9.2018	Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së shërbimit social shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.....	9601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 3.10.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	9604
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 3.10.2018	Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore.....	9612
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 3.10.2018	Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve.....	9613
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 572, datë 3.10.2018	Për rishpërndarje fondesh brenda programeve buxhetore të buxhetit të vitit 2018, miratuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit..	9614
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 573, datë 3.10.2018	Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë.....	9614
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 3.10.2018	Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 3.13 ha, që do të përdoret nga shoqëria "Doruz" sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit ranor-pllakor në objektin "Bregu i Kallmit", Bashkia Skrapar.....	9619
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 3.10.2018	Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 4 ha, që do të përdoret nga shoqëria "Fonsana Griggio" sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit ranor-pllakor, në objektin "Guri i Zi", Bashkia Elbasan.....	9622

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 577, datë 3.10.2018	Për disa shtesa në vendimin nr. 714, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kukës–Krumë".....	9625
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 10, datë 28.9.2018	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara "Sekret shtetëror".....	9627

VENDIM
Nr. 555, datë 29.9.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES, TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË E MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", si dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijojnë:

a) Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 2, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. kreu 1.2 zëvendësohet me kreun 1.2, me titull "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ii. në kreun 1.4, pas emërtimit "Zëvendësdrejtor" shtohet nënndarja, si më poshtë vijon:

	Drejtor drejtorie	1	2%		65.000		

b) Në lidhjen nr. 2, të përmendur në pikën 3, kreu 2.2 shfuqizohet.

2. Efektet financiare, për vitin 2018, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë vit dhe të fillojnë:

a) Për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, nga momenti i transferimit të punonjësve në pozicionet e reja pas miratimit të strukturave dhe të organikave përkatëse;

b) Për parashikimet e tjera, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1 (kreu 1.2)
Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

I. Në drejtorinë qendrore dhe në drejtoritë rajonale

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifi-kim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	nga ... deri ... lekë
1	Drejtor i përgjithshëm	1	2%		118.100		
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm. Drejtor drejtorie në drejtorinë qendrore.	1	2%		100.000		
3	Drejtor i drejtorisë rajonale.	1	2%		95.000		

4	Përgjegjës sektori në drejtorinë qendrore. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale.	1	2%		80.700		
5	Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale.	1	2%		61.000		
6	Specialist (niveli i parë)	1 ose 2, ose 3	2%		49.000		
7	Specialist (niveli i dytë)	1 ose 2, ose 3	2%		38.000		

II. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor

	EMËRTIMI	**PAGA MUJORE**					
		Paga e grupit (PG)	**Shtesa për vjetërsi (SHV)**	**Shtesa për kualifi-kim (SHK)**	**Shtesa për pozicion (SHP)**	**Shtesa për kushte pune (SHKP)**	**Totali**
		1	**2**	**3**	**4**	**5**	**nga ... deri ... lekë**
1	Titullar i njësive vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe	1	2%		90.800		
2	Titullar i njësive vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki	1	2%		80.700		
3	Shef shërbimi	1	2%		64.000		
4	Përgjegjës sektori	1	2%		42.000		
5	Përgjegjës i shërbimeve të shëndetit mendor	1	2%		49.500	5.000	
6	Mjek/specialist në shërbimet e shëndetit publik	1	2%		42.000	7.000	
7	Mjek/stomatolog/farmacist/inxhinier	1	2%		42.000		
8	Mjek/psikolog/punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor	1	2%		42.000	5.000	
9	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%		38.200		
10	Kryeinfermier/kryevaksinator	1	2%		35.200		
11	Teknik specialitetesh shëndetësore	1 ose 2, ose 2, ose 3, ose 4 ose 5	2%		31.000	1.100	
12	Infermier në shërbimet e shëndetit mendor	1 ose 2, ose 2, ose 3, ose 4, ose 5	2%		31.000	5.000	
13	Infermier	1 ose 2, ose 2 ose 3, ose 4, ose 5	2%		31.000		

VENDIM
Nr. 556, datë 29.9.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 60, DATË 31.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2018, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 60, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijojnë:

a) Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 1 995 punonjës.";

b) Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, të përmendur në pikën 1 të tij, në ndarjen "Gr. 78, institucione të tjera qeveritare", shtohet nënndarja "Departamenti i Administratës Publike", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Në pikën 2 të vendimit, pas emërtesës "specialist në Sekretariatin Teknik të Komisionit të Dhënies së Dëshmisë së Statusit të Naftëtarit" shtohet emërtesa "Punonjës shërbimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve".

2. Mbulimi i efekteve financiare për punonjësit e kontraktuar bëhet nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Departamentin e Administratës Publike për vitin 2018.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Gr.	Emri i institucionit	Numri i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
87	**Institucione të tjera qeveritare**	**6**			
	Departamenti i Administratës Publike	6	Specialistë	8 orë/ditë	Tetor–dhjetor

VENDIM
Nr. 560, datë 29.9.2018

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pikat 2 e 3, 10 dhe 101, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 9, pika 7, 10 e 13, shkronja "c", të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore për qytetarët, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e tjera dhe palët e treta, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tarifat e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, arkëtohen, parapaguhen para ofrimit të shërbimit përkatës, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të Postës Shqiptare, në adresë të Degës së Thesarit Tiranë, me përfitues Qendrën e Shërbimeve Arsimore, Tiranë.

3. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e parapaguara për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore janë të pakthyeshme.

4. Pjesa prej 90% e të ardhurave, që i takon Qendrës së Shërbimeve Arsimore, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në programin buxhetor 09450, kapitulli 06, "Të ardhurat e veta jashtë limitit".

5. Të ardhurat që sigurohen nga këto tarifa menaxhohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe përdoren për:

a) Mbulimin e shpenzimeve të personelit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Në shpenzime personeli përfshihen pagat e punonjësve, si dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore;

b) Mbulimin e shpenzimeve të veprimtarisë së Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ku përfshihen dhe mbulimi i shpenzimeve të hartimit, vlerësimit e korrigjimit të testeve të provimeve, si dhe pagesa e kuotave/tarifave në rrjetet ndërkombëtare;

c) Mbulimin e shpenzimeve për investime në përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve infrastrukturore të QSHA-së.

6. Çdo shërbim tjetër i ofruar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi apo i ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin, për të cilin nuk aplikohet tarifë shërbimi sipas këtij vendimi, financohet nga fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara për ministrinë përgjegjëse për arsimin.

7. Të ardhurat e papërdorura gjatë një viti financiar kalojnë në vitin pasardhës.

8. Vendimi nr. 812, datë 10.11.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit", shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1
LISTA E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Lloji i shërbimit	Tarifa (lekë)
1. Provimi i shtetit për profesionet e rregulluara:	
a) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të parë:	10 000 lekë;
b) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të dytë:	12 500 lekë;
c) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të tretë:	15 000 lekë;
ç) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të katërt:	17 500 lekë;
d) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të pestë:	20 000 lekë;
e) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati më shumë se pesë herë:	25 000 lekë.

2. Njohja e diplomave, certifikatave e titujve dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit të lëshuara nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, 2 000 lekë për çdo aplikant.

3. Provimi i specializimit në mjekësi, si dhe profesione të tjera të rregulluara, 5 000 lekë për çdo aplikant.

4. Provime të tjera të digjitalizuara, të kërkuara nga institucionet publike dhe private, 5 000 lekë çdo aplikant.

5. Aplikim për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë në sistemin që administrohet nga QSHA-ja, 2 000 lekë për çdo aplikant.

6. Regjistrimi i formës së diplomave dhe certifikatave, 3 000 lekë për diplomë/certifikatë të regjistruar.

7. Tarifa për pajisjen me numrin unik të matrikullimit (për student) 100 lekë;

8. Pajisja e IAL-së me: 2 000 lekë;

a) Regjistrin themeltar të studentëve (për regjistër);

b) Regjistrin e arritjeve akademike;

c) Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

VENDIM
Nr. 561, datë 29.9.2018

PËR PAJISJEN ME TEKSTE SHKOLLORE TË NXËNËSVE, FORMIMIN FILLESTAR, ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM PROFESIONAL TË MËSUESVE, si dhe PËR KRIJIMIN E FUNKSIONIMIN E KLASAVE NË GJUHËN E PAKICAVE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësve të arsimit bazë të pakicave kombëtare, të cilët mësojnë dhe/ose mësohen në gjuhën e pakicës kombëtare, u sigurohen tekstet shkollore falas.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin bashkë-rendon punën me institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore dhe shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, për nevojat e formimit fillestar për mësues që do të zhvillojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare.

3. Trajnimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve që zhvillojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare financohet me fondet e buxhetit të shtetit. Mësuesit trajnohen, të paktën 3 (tri) ditë në vit, me programe trajnimi të akredituara. Njësitë arsimore vendore organizojnë, koordinojnë dhe mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në nivel institucioni arsimor. Procedurat e trajnimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve në nivel institucioni arsimor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga:

a) Njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse;

b) Njësia arsimore vendore përkatëse;

c) Komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare.

5. Për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, kryetari i bashkisë dhe titullari i njësisë përkatëse arsimore vendore, pas konsultimit me përfaqësues të pakicave kombëtare, i paraqesin propozimin përkatës ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Propozimi për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në institucionet arsimore parauniversitare publike shoqërohet me studimin mbi argumentimin e domosdoshmërisë së hapjes së klasave me nxënës të pakicave kombëtare, si dhe me kontributin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

7. Propozimi për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare paraqitet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para fillimit të vitit mësimor.

8. Klasat në gjuhën e pakicave kombëtare hapen kur plotësohen kriteret si më poshtë vijojnë:

a) Ndërtesa e institucionit arsimor dhe mjediset e saj të plotësojnë standardet sipas legjislacionit në fuqi;

b) Institucioni arsimor të jetë i pajisur me mjete mësimore për funksionimin normal të procesit mësimor;

c) Numri i nxënësve të pakicave kombëtare të jetë jo më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë;

ç) Personeli mësimor i klasave me nxënës të pakicave kombëtare plotëson kriteret profesionale dhe është emëruar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

9. Në kushte të veçanta, kur numri i fëmijëve apo i nxënësve të pakicave kombëtare është më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë, funksionimi i klasave në gjuhën amtare të pakicës kombëtare bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Efektet financiare për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare të parashikohen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

11. Nisma për mbylljen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga:

a) Ministri përgjegjës për arsimin;

b) Njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse;

c) Njësia arsimore vendore përkatëse.

12. Kryetari i bashkisë dhe titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse, në rastet kur institucioni arsimor nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi, i paraqesin ministrit përgjegjës për arsimin propozimin për mbylljen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në institucionin arsimor publik, pas konsultimit me

përfaqësues të komunitetit të pakicës kombëtare, ku ndodhet institucioni arsimor publik.

13. Hapja dhe mbyllja e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

14. E drejta për arsim në gjuhën e pakicës kombëtare nuk duhet të cenojë mësimin e gjuhës shqipe.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 562, datë 29.9.2018

PËR MASAT E PËRSHTATSHME PËR NXITJEN E NJOHJES SË KULTURËS, HISTORISË, GJUHËS DHE BESIMIT FETAR TË PAKICAVE KOMBËTARE NË VEPRIMTARINË MËSIMORE DHE SHKENCORE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, të përfshijnë në veprimtarinë e tyre mësimore njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit të përfshijnë, të mbështesin dhe të inkurajojnë realizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore lidhur me njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nëpërmjet aktiviteteve, fushatave sensibilizuese dhe koordinimit me institucionet e arsimit të lartë, promovon njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

4. Efektet financiare të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve, fushatave sensibilizuese që do të ndërmerren me nismën e ministrisë përgjegjëse për arsimin, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore e shkencore, të realizuara nga institucionet e arsimit të lartë, do të përballohen nga të ardhurat e vetë institucioneve të arsimit të lartë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 563, datë 29.9.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 203, DATË 16.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E KULTURËS, TË PRONËS NR. 186, ME EMËRTIM "REPARTI USHTARAK NR. 3042, QENDËR STËRVITORE", ME VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të

ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 203, datë 16.3.2016, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve..." shfuqizohen.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 564, datë 29.9.2018

PËR DHURIMIN UNESCO-s TË IKONËS "NGJALLJA E LLAZARIT", NË KUADËR TË 60-VJETORIT TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË KËTË ORGANIZATË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhurimin UNESCO-s të ikonës "Ngjallja e Llazarit", në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë, me të dhënat sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Dhurimi i ikonës "Ngjallja e Llazarit" UNESCO-s të bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe sigurimin e kushteve për ruajtjen e këtij objekti muzeor gjatë transportimit të tij brenda dhe jashtë vendit.

3. Ngarkohet Ministria e Kulturës për lidhjen e kontratës së dhurimit.

4. Ngarkohet Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Arsimit dhe Arkelologjik, Korçë, të kryejë procedurat për shoqërimin e ikonës "Ngjallja e Llazarit" deri në dorëzimin e saj tek UNESCO-ja.

5. Ngarkohet Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e veprimit të dhurimit të ikonës dhe monitorimin deri në tjetërsimin e pronësisë së veprës.

6. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E IKONËS "NGJALLJA E LLAZARIT"

IKONA PËR DHURIM						
MUZEU KOMBËTAR I ARTIT MESJETAR, ARSIMIT DHE ARKEOLOGJIK, KORÇË						
Nr. rend.	**EMËRTIMI**	**AUTORI**	**NR. INV.**	**KODI QKIPK**	**PERIUDHA**	**FOTO**
1	NGJALLJA E LLAZARIT	KOSTANDIN DHE ATHANAS ZOGRAFI	2181	28337	Shek. XVIII	

VENDIM
Nr. 565, datë 29.9.2018

PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMTARISË NDËRMJET MEKANIZMAVE KËSHILLIMORË DHE KOORDINUES INSTITUCIONALË DHE STRUKTURAVE NË NIVEL QENDROR E VENDOR, PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, pika 5, e 38, pika 4, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton rregullat për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

2. Procesi i bashkërendimit të veprimtarisë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bazohet në:

a) Parimin e informimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të autoriteteve dhe mekanizmave shtetërorë të çdo informacioni, studimi, të dhënë apo iniciative në fushën e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

b) Parimin e konsultimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

c) Parimin e angazhimit të çdo organi shtetëror në nivel qendror e vendor të përfshirë sipas ligjit në çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

ç) Parimin e bashkëpunimit dhe të dialogut konstruktiv.

3. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës bashkëpunon me ministritë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, përmes:

a) Hartimit e koordinimit të politikave, të akteve ligjore dhe nënligjore, studimeve, vlerësimeve, raportimeve, si dhe realizimit të projekteve të përbashkëta për monitorimin e raportimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

b) Hartimit të udhëzimeve përkatëse lidhur me referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mënyrat e format e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve në nivel qendror dhe strukturave në nivel rajonal ose vendor me strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor;

c) Ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

4. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës bashkëpunon me bashkitë, lidhur me:

a) Ngritjen e kapaciteteve për monitorimin dhe raportimin e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor, me pjesëmarrjen e organizatave jofitimprurëse dhe të fëmijëve;

b) Organizimin e aktiviteteve dhe të trajnimeve që synojnë rritjen e kapaciteteve lidhur me zbatimin, monitorimin dhe raportimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve;

c) Hartimin, buxhetimin dhe zbatimin e planeve lokale për mbrojtjen e fëmijëve si pjesë e planeve sociale vendore;

ç) Vendosjen dhe formalizimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe organizatave jofitimprurëse me qëllim ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

d) Planifikimin, hartimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve.

5. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në bashki dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në nivel njësie administrative lidhur me:

a) Monitorimin e zbatimit të detyrave të këtyre strukturave, të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";

b) Mbështetjen teknike lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe lehtësimin e koordinimit ndërinstitucional për zbatimin e planit individual të mbrojtjes;

c) Rritjen e kapaciteteve lidhur me zbatimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve;

ç) Mbledhjen periodike të të dhënave statistikore për mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë/njësisë administrative, të përcaktuara në aktet nënligjore, si dhe informacionit lidhur me aktivitetin e tyre, procesin, mënyrën e menaxhimit të rasteve dhe problematikave të hasura.

6. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në nivel qendror e vendor bashkë-punojnë ndërmjet tyre për:

a) Identifikimin e adresimin institucional të problematikave lidhur me shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, ligjore, kulturore, regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile, si dhe çdo problematikë tjetër lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor;

b) Referimin, raportimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

c) Funksionimin efektiv të grupeve teknike ndërsektoriale në nivel bashkie/njësie administrative dhe përmbushjen e detyrimeve institucionale në kuadër të planit individual të mbrojtjes;

ç) Kryerjen e trajnimeve dhe programeve të përbashkëta për kualifikimin e personave përgjegjës në këto struktura për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe, në veçanti, lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të tyre, për:

i. realizimin, monitorimin e raportimin e të drejtave të fëmijëve;

ii. funksionimin në mënyrë efektive të grupit teknik ndërsektorial;

iii. zbatimin e planeve individuale të mbrojtjes së fëmijëve në nevojë për mbrojtjen dhe realizimin efektiv të mbrojtjes së fëmijëve.

d) Shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve me qëllim monitorimin dhe raportimin e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor.

7. Vendimi nr. 266, datë 12.4.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për bashkërendimin e veprim-tarisë së mekanizmave në nivel qendror e vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës", shfuqizohet.

8. Ngarkohen strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në nivel qendror e vendor, të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", si edhe institucionet qendrore, që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështjet e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 566, datë 29.9.2018

PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË E TË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE AFTËSINË E KUFIZUAR NË STRUKTURAT E VARËSISË SË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR DHE PRANË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "e", të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrolli i ndihmës ekonomike dhe pagesës për personat me aftësi të kufizuara bëhet nga struktura përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kontrolli i strukturave rajonale dhe me përzgjedhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet nga struktura përgjegjëse e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror, bazuar në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit miratohet nga titullari i institucionit, sipas modelit standard, të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

3. Kontrolli i njësive të vetëqeverisjes vendore nga strukturat përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror në nivel rajonal bazohet në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit miratohet nga

titullari i institucionit, sipas modelit standard, të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

4. Programi i kontrollit duhet të përmbajë:

a) Subjektet, që do të kontrollohen;

b) Llojin e kontrollit, që do të ushtrohet;

c) Periudhën, për të cilën do të bëhet kontrolli;

ç) Objektivat që duhet të realizohen.

5. Kontrolli programohet për çdo muaj. Kontrolli mund të jetë i plotë ose tematik, sipas analizës së riskut. Në çdo rast, përpara kryerjes së kontrollit subjekti njoftohet me shkrim për fillimin e kontrollit, qëllimin, si dhe objektivat që do të realizohen. Kontrolli nga struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar, në nivel qendror ose rajonal, do të jetë si më poshtë vijon:

a) Struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar në nivel qendror kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet për strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe, duke zbatuar metodën me përzgjedhje, në bazë të analizës së riskut, kryen kontrolle tematike për veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore;

b) Struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar në nivel rajonal kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe kontrolle tematike, sipas analizës së riskut, në përputhje me programin e kontrollit, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.

6. Kontrolli mund të jetë i paparalajmëruar, në rastet kur ka sinjalizime për abuzime ose shkelje ligjore nga subjekti përkatës.

7. Sinjalizime konsiderohen:

a) Njoftime me shkrim ose me mjete të tjera komunikimi të personave të interesuar për veprimtarinë e subjektit, pasi ky veprim të jetë vlerësuar si abuziv;

b) Njoftime ose ankime të çdo forme, nga entet publike;

c) Raporte specifike, të gjeneruara nga sistemi.

8. Grupi i kontrollit në nivel qendror ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, për:

a) Veprimtarinë e strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe, me përzgjedhje, të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike;

b) Veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike, duke kryer me përzgjedhje, sipas analizës së riskut, kontrolle tematike;

c) Procedurën e kryerjes së verifikimeve automatike në drejtoritë rajonale, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike dhe verifikimeve manuale, nëse ka;

ç) Procedurën e vendimmarrjes për familjet aplikuese dhe përfituese të ndihmës ekonomike;

d) Performancën e strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në kryerjen e kontrollit të ndihmës ekonomike në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

9. Grupi i kontrollit të strukturave rajonale ushton kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, për:

a) Veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit përkatës për ndihmën ekonomike;

b) Dokumentacionin dhe procedurën e kryerjes së aplikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike, si dhe dokumentacionin në dosjen e përfituesit të ndihmës ekonomike;

c) Dokumentacionin e kategorive përfituese të ndihmës ekonomike dhe afatin e vlefshmërisë së përfitimit, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) Kryerjen e verifikimeve social-ekonomike nga administratorët shoqërorë, afatet dhe pasqyrimin e tyre në sistem;

d) Përputhshmërinë e deklarimit të familjes përfituese me vizitën në shtëpi, të pasqyruar nga administratori shoqëror në sistem, nëpërmjet realizimit të verifikimeve social-ekonomike me përzgjedhje;

dh) Familjet që kanë rezultuar me deklarim të rremë dhe afatin e përjashtimit të tyre nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore, sipas legjislacionit në fuqi;

e) Deklarimet tremujore të ndryshimit të situatës social-ekonomike të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike;

ë) Aplikimet e familjeve që kanë në përbërjen e tyre një person me aftësi të kufizuara, invalid pune etj.;

f) Procedurën e ndjekur ndërmjet bashkisë dhe postës/bankës për rakordimin dhe marrjen e informacionit për listën emërore të familjeve që nuk kanë tërhequr ndihmën ekonomike brenda afatit, si dhe ndjekjen e procesit të largimit të familjes nga përfitimi i ndihmës ekonomike;

g) Përputhjen ndërmjet borderosë dhe thesarit, numrit të familjeve përfituese dhe shumave të përfitimit të ndihmës ekonomike;

gj) Saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;

h) Mënyrën e planifikimit të fondit të ndihmës ekonomike dhe plotësimin e të dhënave statistikore, sipas legjislacionit në fuqi;

i) Procedurat dhe dokumentacionin e shpërndarjes së pagesave të ndihmës ekonomike për familjet që mbështeten me fondin deri në 6%, në bazë të kritereve të miratuara nga këshilli bashkiak dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

j) Dokumentacionin dhe pagesat e kompensimit të energjisë elektrike për familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike.

10. Grupi i kontrollit në nivel qendror dhe rajonal ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara, për:

a) Veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësitë administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për pagesën e aftësisë së kufizuar;

b) Dokumentacionin e përfitimeve të aftësisë së kufizuar në dosjen fizike të përfituesit;

c) Përputhjen ndërmjet listëpagesave dhe thesarit, numrit të përfituesve dhe shumave të përfitimit të pagesës për aftësinë e kufizuar;

ç) Saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;

d) Mënyrën e planifikimit të fondit të pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Grupi i kontrollit harton projektraportin për kontrollin e kryer dhe një kopje ia dorëzon subjektit të kontrolluar, i cili, brenda 10 ditëve pune paraqet vërejtjet apo kundërshtitë, nëse ka, të argumentuara me dokumentacionin përkatës.

12. Raporti përfundimtar i kontrollit bëhet nga grupi i kontrollit, i cili vlerëson vërejtjet apo kundërshtitë e subjektit të kontrolluar dhe jep argumentet përkatëse në raport.

13. Titullari i institucionit ia paraqet raportin përfundimtar:

a) Kryetarit të Bashkisë;

b) Prefektit të qarkut;

c) Drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror;

ç) Drejtorit rajonal të Shërbimit Social Shtetëror.

14. Në raportin përfundimtar evidentohen të gjitha shkeljet e konstatuara nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar, propozimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe masat për personat përgjegjës, si më poshtë vijon:

a) Masë disiplinore për shkelje nga strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, lidhur me:

i. verifikimin e të dhënave nëpërmjet regjistrit kombëtar elektronik dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse;

ii. caktimin e familjes/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike;

iii. refuzimin e përfitimit të ndihmës ekonomike;

iv. dërgimin e vendimit kryetarit të bashkisë.

b) Masë disiplinore për shkelje nga struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, lidhur me:

i. hartimin e projektvendimit për familjet/individët në nevojë/përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar;

ii. propozimin e tij në këshillin bashkiak;

iii. hartimin e kërkesave për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës;

iv. grumbullimin dhe përgatitjen e informacioneve e të statistikave;

v. regjistrin e përfituesve;

vi. ndjekjen e shpenzimeve për ndihmën ekonomike dhe pagesat e personave me aftësi të kufizuara.

c) Masë disiplinore për shkelje, në lidhje me:

i. identifikimin e familjeve që kanë nevojë për ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara;

ii. verifikimin e gjendjes shoqërore dhe ekonomike të familjeve në nevojë;

iii. paraqitjen e të dhënave pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki për familjet/individët në nevojë, të cilët kanë

aplikuar për ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara;

iv. përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar;

v. hartimin e kërkesave për bllokndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuara çdo dymujor;

vi. hedhjen në regjistrin elektronik kombëtar të të dhënave të deklaruara nga aplikuesit për ndihmë ekonomike.

ç) Gjobë, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, në rastet kur vërehet që shkeljet e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të kësaj pike, janë kryer në mënyrë të përsëritur;

d) Shpërblimin e dëmit nga administratori shoqëror dhe/ose familja dhe/ose punonjësi i strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nëse konstatohet se është shkaktuar dëm ekonomik;

dh) Kallëzim penal, në rast se dyshohet se janë konsumuar elementet e veprës penale. Struktura përgjegjëse për kontrollin e ndihmës ekonomike dhe të pagesave për personat me aftësi të kufizuara, kur vlerëson se janë konsumuar elementet e veprës penale nga personat e ngarkuar për zbatim, bën kallëzimin penal pranë autoriteteve kompetente për shkelësit e ligjit.

Çdo shkelje e menaxhimit të fondeve buxhetore, që programohen e përdoren për ndihmën ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas përcaktimeve të nenit 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

15. Vendimi nr. 512, datë 31.5.2006, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore", i ndryshuar, shfuqizohet.

16. Ngarkohet ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për nxjerrjen e udhëzimeve për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike, metodologjinë e kontrollit të pagesave të aftësisë së kufizuar dhe mekanizmat e monitorimit.

17. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM[1]
Nr. 569, datë 3.10.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja "e", 16, pika 8, 20, pika 4, 22, pika 5, 24, pikat 1, 5 e 6, 30, pikat 1 e 6, 34, pika 5, 38, pika 1, 42, pika 5, 56, pika 1, shkronjat "a" e "dh", 65, pika 3, dhe 145, pika 3, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I, "Dokumentacioni dhe procedura për hyrjen e qëndrimin e të huajve në

[1] Ky vendim është përafruar pjesërisht me:
- Direktivën 2004/114/KE, datë 13 dhjetor 2004, "Mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime studimi, trajnime pa pagesë ose shërbime vullnetare", numri CELEX 32004L0114, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 375, datë 23.12.2004, faqe 12–18;
- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003, "Mbi të drejtën e bashkimit familjar", numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, faqe 12–18;
- Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, "Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta, me qëllim pune tepër të kualifikuar", numri CELEX 32009L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 155, datë 18.6.2009, faqe 17–29.

Republikën e Shqipërisë", bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

a) Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

i. shkronja "c" ndryshohet si më poshtë vijon:

"c) Çdo lloj dokumenti, i cili vërteton akomodimin e personit";

ii. në shkronjën "ç", pas fjalëve "... Leja e punës ..." shtohen fjalët "... kopje certifikate regjistrimi në punë ...";

iii. në fund të shkronjës "d", shtohen fjalët "... në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë për ditë qëndrimi për të rriturin dhe 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për të miturin.".

b) Në shkronjën "b", të pikës 2, fjalët "... hyrja në territor ..." zëvendësohen me "... hyrja/dalja në/nga territori ...".

c) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1 Të huajit të pajisur me leje qëndrimi të përkohshme, i cili qëndron jashtë territorit për një periudhë më shumë së 6 muaj pa ndërprerje, pa arsye të bazuar në dokumente dhe pa njoftuar autoritetin vendor për migracionin, i ndalohet hyrja me këtë leje qëndrimi.".

2. Në kreun II, "Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në ndarjen A bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

i. në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

- Në fjalinë e parë, pas fjalëve "... në Republikën e Shqipërisë me vizë, ..." shtohen fjalët "... përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, ...";

- Në fjalinë e dytë, fjalët "... dhe me miratimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe të ambasadorëve të Republikës së Shqipërisë, në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit.", zëvendësohen me "... ose të ambasadorëve dhe konsujve të përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe me miratimin e autoritetit përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.".

ii. në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

- Në fund të shkronjës "b" shtohen fjalët "... në respekt dhe në zbatim të parimit të reciprocitetit;";

- Shkronjat "c", "ç", "d" dhe "e" hiqen.

iii. pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

"4.1 I huaji mund të aplikojë për vizë jashtë listës së aneksit 4, me kusht që të jetë rezident mbi 12 muaj në vendin ku kërkon të aplikojë. Në këto raste, aplikuesi, krahas dokumentacionit të kërkuar për aplikim, duhet të paraqesë dhe kopje të lejes së qëndrimit, me vlefshmëri të paktën 3 (tre) muaj më shumë së afati i vizës së kërkuar.".

iv. në pikën 5, pas fjalëve "... bëhet vetëm me miratim të ... " shtohen fjalët "... transferimit të aplikimit nga ...".

v. pas shkronjës "c", të pikës 6, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Përditësimi i listës në anekset 2 dhe 3, për kategorinë e shtetasve sipas shkronjës "c", të pikës 6 të këtij vendimi, bëhet nga autoriteti përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në mënyrë periodike ose në varësi të ndryshimeve që kërkohet të reflektohen.".

vi. në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

- Para fjalisë së parë shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

"Aplikimi për vizë bëhet kryesisht *online*.".

- Pas shkronjës "dh" shtohen shkronjat "e" dhe "ë", me këtë përmbajtje:

"e) Të huajt, sipas përcaktimeve në pikën 6, të nenit 24, të ligjit nr. 108/2013, të ndryshuar;

ë) Të huajt, të cilët aplikojnë pranë zyrave konsullore të nderit të Republikës së Shqipërisë, si dhe pranë zyrave të agjentëve të tjerë të kontraktuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në shtete të huaja, për këtë qëllim.".

b) Në ndarjen B bëhen këto ndryshime:

i. në paragrafin e parë, pas fjalëve "... të përfaqësive të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit, ..." shtohen fjalët "... zyrave konsullore të nderit të Republikës së Shqipërisë, si dhe zyrave të agjentëve të tjerë të kontraktuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në shtete të huaja, ...";

ii. në pikën 6, në fund të paragrafit të dytë, shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

"Përjashtohen nga detyrimi i depozitimit të ftesës, aplikuesi për vizë të tipit C - turizëm, si dhe i huaji investitor/administrator/i vetëpunësuar në Republikën e Shqipërisë, që aplikon për vizë D/APU, me kusht depozitimin e një numri kontakti në Republikën e Shqipërisë.".

c) Në ndarjen C bëhen këto ndryshime:

i. pas shkronjës "c", të pikës 2, shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) Dokument, që vërteton ekzistencën e një marrëdhënieje punësimi të qëndrueshme në vendin e origjinës/qëndrimit. Në mungesë të kësaj marrëdhënieje punësimi, i huaji duhet të vërtetojë se ka interesa për t'u kthyer në vendin e origjinës/qëndrimit.".

ii. në pikën 8 bëhen këto ndryshime:

- Në fund të shkronjës "a" shtohen fjalët "... me përjashtim të rastit kur i huaji është investitor/administrator/i vetëpunësuar në Republikën e Shqipërisë;".
- Pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Kopje të vërtetimit të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) e legalizuar ose e apostiluar.".

iii. pas shkronjës "d", të pikës 9, shtohet shkronja "dh", me këtë përmbajtje:

"dh) Kopje të vërtetimit të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) e legalizuar ose e apostiluar.

iv. pas shkronjës "d", të pikës 10, shtohen shkronjat "dh" dhe "e", me këtë përmbajtje:

"dh) Për rastet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 65, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, dokument i lëshuar nga institucionet shqiptare apo shteti ku aplikuesi banon, me të cilin provohet se i huaji ka apo ka pasur së paku njërin prind ose gjysh me shtetësi shqiptare;

e) Kopje të vërtetimit të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) e legalizuar ose e apostiluar.".

v. Pas shkronjës "c", të pikës 11, shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) Kopje të vërtetimit të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) e legalizuar ose e apostiluar.".

vi. Pas shkronjës "ç", të pikës 13, shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Kopje të vërtetimit të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) e legalizuar ose e apostiluar.".

3. Në kreun III, "Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me leje qëndrimi", bëhen këto ndryshime:

a) Në ndarjen A bëhen këto ndryshime:

i. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Aplikimi për leje qëndrimi për herë të parë depozitohet personalisht, ndërsa për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit depozitohet personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar (në rast se aplikuesi është i mitur, autorizimi mund të bëhet nga njëri prind), me kusht që i huaji të ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në momentin e aplikimit, sipas afateve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 38, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, si më poshtë vijon:

a) Brenda 30 ditëve pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) Deri në 60 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes ekzistuese të qëndrimit për ripërtëritjen e saj;

c) Përtej afatit të përcaktuar në shkronjën "b", të kësaj pike, për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit në rrethana të jashtëzakonshme, pas vlerësimit të tyre nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin.".

ii. në pikën 2, në fund të fjalisë së parë, shtohen fjalët "... me përjashtim të lejes së qëndrimit tipi A ...".

iii. pikat 4, 5 e 6 ndryshohen dhe pas tyre shtohen pikat 7, 8, 9 e 10, me këtë përmbajtje:

"4. Përjashtohen nga pagesa e tarifës së shërbimit dhe/ose vlera e dokumentit biometrik leje qëndrimi kategoritë, si më poshtë vijojnë:

a) Për të huajt, që punojnë në organizata dhe shoqata jofitimprurëse, bamirëse, humanitare, fondacione dhe shoqata fetare, në bazë të parashikimeve në marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe të lidhura me shtetin shqiptar për përjashtimin nga taksat, si dhe për kategoritë e përcaktuara në pikën 1/1, të nenit 105, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, është falas vetëm tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi, ndërsa vlera e dokumentit biometrik leje qëndrimi do të përballohet nga vetë personi;

b) Për kategoritë e përcaktuara në nenet 54, 58 dhe 61, pika 1, shkronja "dh", të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi është falas, ndërsa vlera e dokumentit biometrik leje qëndrimi mbulohet nga buxheti i autoritetit shtetëror që trajton këto kategori;

c) Për kategoritë që, në bazë të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, përfitojnë leje qëndrimi tipi A, në format A4, sipas anekseve 6/1 e 6/2, pjesë përbërëse e këtij vendimi, tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi është falas.

5. Dokumentacioni i marrë në vendin e origjinës dhe/ose në vendin ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm për 6 muajt e fundit, duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar, i vërtetuar dhe i legalizuar, bazuar në legjislacionin në fuqi për vërtetimin e legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja për përdorim brenda vendit.

Fotokopjet e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që depozitohen në momentin e aplikimit për leje qëndrimi, duhet të jenë të shoqëruara me dokumentin origjinal para punonjësit të autoritetit rajonal për kufirin dhe migracionin që pranon aplikimin.

6. Dëshmi të burimeve të mjaftueshme financiare për jetesën në Republikën e Shqipërisë, e cila konsiston në paraqitjen e një vërtetimi depozite bankare në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri ose të ardhura personale apo familjare, në përputhje me koston e jetesës, që përkon të paktën me standardin minimal të jetesës në Shqipëri dhe, respektivisht:

a) Depozitë bankare, jo më pak se 300 000 (treqind mijë) lekë për person (për një vit kalendarik);

b) Të ardhura mujore, jo më pak se 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë për person.

7. Leja e qëndrimit për herë të parë jepet në përputhje me motivin e vizës, në bazë të të cilit i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, si dhe tipin e afatin e lejes së punës për personat e punësuar apo të vetëpunësuar. Afati i lejes së qëndrimit nuk mund të jetë më shumë se 3 (tre) muaj nga data e përfundimit të vlefshmërisë së lejes së punës.

8. Ripërtëritja e lejes së qëndrimit refuzohet nëse i huaji ka munguar në territor për një periudhë totale mbi 6 muaj brenda një viti kalendarik dhe atij nuk i është miratuar paraprakisht nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin kërkesa ku ka motivuar mungesën në territor për këtë periudhë.

9. Për të huajt që aplikojnë për leje të përhershme qëndrimi, periudha e ndërprerjeve në mes lejeve të qëndrimit deri në 6 (gjashtë) muaj, kur në total nuk i kalojnë 10 (dhjetë) muaj, brenda 5 (pesë) viteve të qëndrimit me leje qëndrimi, nuk konsiderohet pengesë për lëshimin e lejes së përhershme të qëndrimit.

10. I huaji që ka përfituar leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë mund të aplikojë për ripërtëritjen e saj për një motiv të ndryshëm nga motivi i lejes paraardhëse, me kusht që:

a) Të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim për motivin e kërkuar;

b) Afati i lejes së qëndrimit të mos jetë më shumë se 1 (një) vit.

Nëse i huaji kërkon të ndryshojë motivin e lejes së qëndrimit, brenda afatit të vlefshmërisë së lejes (me përjashtim të lejes për herë të parë), ai mund të aplikojë për një leje të re qëndrimi me afat jo më shumë se 1 vit, pas dorëzimit të lejes së vlefshme të qëndrimit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin dhe plotësimit të kushteve të përmendura në shkronjat "a" e "b" të kësaj pike.".

b) Në ndarjen B bëhen këto ndryshime:

i. në pikën 1, pas fjalëve "... aplikimit për leje qëndrimi ..." shtohen fjalët "..., që përmban dhe kërkesën, ...".

ii. në pikën 2, fjalët "Dy fotografi ..." zëvendësohen me fjalët "Tri fotografi ...".

iii. në pikën 3 hiqet paragrafi i dytë.

iv. pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Kontratën e blerjes ose të marrjes me qira të ndërtesës së banimit, në përputhje me standardet e banimit në Republikën e Shqipërisë (minimumi 20 (njëzet) m^2 për person) ose çdo dokument tjetër që provon strehimin e garantuar në Republikën e Shqipërisë. Kontrata e qirasë duhet të hartohet në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.".

c) Në ndarjen C bëhen këto ndryshime:

i. Në shkronjën "c", të pikës 1, pas fjalëve "... kontratës së punës ..." shtohen fjalët "... ku ndër të tjera të përcaktohet edhe paga ..." dhe pas saj shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) Vërtetim të regjistrimit në zyrën e tatimeve për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.".

ii. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

- Pas shkronjës "a" shtohen nënndarjet "i" "ii" dhe "iii", me këtë përmbajtje:

"i. në rast se i huaji kryen veprimtari të pavarur ekonomike, i regjistruar pranë QKB-së si "person fizik", fotokopje e lejes së punës e tipit B/VP ose e certifikatës së regjistrimit në punë, sipas rasteve të përcaktuara në ligj.

ii. Në rast se i huaji kryen veprimtari të pavarur ekonomike si investitor, fotokopje e lejes së punës

së tipit B/I ose e certifikatës së regjistrimit në punë, sipas rasteve të përcaktuara në ligj.

iii. në rast se i huaji është "ortak" i një shoqërie tregtare, por nuk është i punësuar në këtë shoqëri, nuk kërkohet leje pune.".

- Në shkronjën "c", në fund të fjalisë, shtohen fjalët "... dhe ekstraktin e muajit të fundit të shoqërisë të nxjerrë nga QKB-ja.".

iii. në pikën 3, pas shkronjës "b" shtohen shkronjat "c" e "ç", me këtë përmbajtje:

"c) Dokument kualifikimi për punë specifike;

ç) Vërtetim të regjistrimit në zyrën e tatimeve për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.".

iv. në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në nënndarjen "iii", të pikës "c", shtohen fjalët "... me të cilën do t'i zhvillojë studimet në Republikën e Shqipërisë, për shtetasit e huaj joshqipfolës.";

- Në shkronjën "ç", para fjalisë ekzistuese, shtohen fjalët "Fotokopjen e lejes së punës ose ...";

- Në shkronjën "d", pas fjalëve "organizatave jofitimprurëse", shtohet fjala "të huaja".

- Në nënndarjen "i", të shkronjës "d", pas fjalës "Fotokopja" shtohen fjalët "... e lejes së punës ose ...".

v. në shkronjën "a", të pikës 6, në fund të fjalisë, shtohen fjalët "... ku të shprehet shlyerja e detyrimit financiar ...".

vi. pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Dokumente shtesë për leje të përkohshme qëndrimi për bashkim familjar të tipit B janë si më poshtë vijon:

a) Kur ftuesi është shtetas i huaj, paraqitet:

i. kopje e lejes së qëndrimit të familjarit ftues prezent në territor (përjashtohen të huajt me qëndrim për motiv bashkimi familjar dhe studentët);

ii. certifikata e lindjes dhe/ose familjare dhe/ose e martesës, ku të tregohet, sipas rastit, lidhja me ftuesin (kur ky dokumentacion jepet vetëm një herë nga vendi i origjinës së aplikuesit, kopje e këtij dokumenti së bashku me deklaratën noteriale të ftuesit, në të cilën deklarohet lidhja familjare e tij me aplikuesin);

iii. dëshmia e burimeve financiare të ftuesit të huaj për përballimin e jetesës, e cila të përkojë të paktën me standardin minimal të jetesës në Shqipëri;

iv. deklarata noteriale/marrëveshja noteriale e personave bashkëjetues, ku të shprehet një bashkëjetesë për më shumë së 12 muaj, shoqëruar me certifikatat personale që vërtetojnë statusin civil pa lidhje martesore të partnerëve;

v. dokument ku vërtetohet dhënia e pëlqimit të prindit tjetër/prindërve, kur kërkohet bashkimi familjar i të miturit/miturve;

vi. për rastet e bashkimit familjar me të huaj me status mbrojtjeje ndërkombëtare, Autoriteti Shtetëror për Azilin dëshmon se ftuesi ka burime të mjaftueshme financiare dhe mundësi akomodimi, në përputhje me standardet në Republikën e Shqipërisë.

b) Kur ftuesi është shtetas shqiptar, paraqitet:

i. kopje e dokumentit të identifikimit të shtetasit shqiptar;

ii. certifikatë familjare dhe/ose e martesës, ku të tregohet sipas rastit lidhja me ftuesin;

iii. deklarata noteriale/marrëveshja noteriale e personave bashkëjetues, ku të shprehet një bashkëjetesë për më shumë se 12 muaj, shoqëruar me certifikatat personale që vërtetojnë statusin civil pa lidhje martesore të partnerëve;

iv. për rastin e përcaktuar në shkronjën "c", dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme të ftuesit për përballimin e jetesës brenda standardeve në Republikën e Shqipërisë.".

vii. pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

"8. Dokumentet për trajtimin me leje qëndrimi për raste humanitare, tipi A, janë si më poshtë vijojnë:

a) Kopje e dokumentit të udhëtimit (nëse i huaji e ka);

b) Kërkesë nga autoritetet përgjegjëse që trajtojnë të huajin, për pajisje me leje qëndrimi, ku përcaktohet statusi ose parashtrohet arsyeja për çdo rast.".

ç) Ndarja Ç ndryshohet si më poshtë vijon:

"Ç. Për ripërtëritjen e lejes së përkohshme të qëndrimit, tipi B, nevojiten këto dokumente:

a) Dokumentacioni i përcaktuar në ndarjen "B", duke përjashtuar pikën 6, dhe dokumentacioni shtesë i përcaktuar në ndarjen C të këtij kreu;

b) Vërtetim i regjistrimit të vendbanimit nga zyra e gjendjes civile në juridiksionin territorial të së cilës është regjistruar vendbanimi i deklaruar;

c) Për kategoritë e përcaktuara në pikat 1, 2 e 3, të ndarjes C, të këtij kreu, dëshminë e shlyerjes së detyrimeve tatimore, vërtetimin e derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore, si dhe ato të taksave vendore për vitin e fundit kalendarik, sipas specifikave të motivit të lejes së qëndrimit;

ç) Për kategorinë e përcaktuar në nënndarjen "iii", të shkronjës "a", të pikës 1, të ndarjes C, të këtij kreu, vërtetimin e shlyerjes se detyrimeve tatimore të shoqërisë, si dhe dokumentacionin me të cilin provohet se shoqëria ka kryer aktivitet për periudhën paraardhëse dhe ka rezultat financiar me fitim;

d) Për kategorinë "punonjës të transferuar", vërtetimin e derdhjes së kontributeve në vendin e origjinës, të legalizuar, të përkthyer dhe të noterizuar;

dh) Për kategorinë "Studentë dhe nxënës shkolle", vërtetim për frekuentimin dhe kalueshmërinë 50% në lëndët e vitit paraardhës.".

d) Në shkronjën "b", të pikës 2, të ndarjes DH, fjalët "... 1 (një) milion euro ..." zëvendësohen me "... 2 (dy) milionë euro ..." dhe fjalët "... 10 (dhjetë) shtetas shqiptarë" zëvendësohen me "... 100 (njëqind) shtetas ...".

dh) Në ndarjen E, pas pikës 3, shtohen pikat 4, 5 e 6, me këtë përmbajtje:

"4. Personat pa shtetësi të lindur në Republikën e Shqipërisë, pajisen me leje qëndrimi për raste të veçanta, tipi C, sipas kërkesave të ndarjes DH të këtij kreu, pasi dorëzojnë një akt të lëshuar nga autoritetet zyrtare shqiptare, i cili vërteton lindjen në Shqipëri të personit.

5. Në rastet e aplikimit për leje qëndrimi në kushte favorizuese dhe lehtësuese të përcaktuara në marrëveshjet e miratuara nga Republika e Shqipërisë, i huaji paraqet, përveç sa është parashikuar në marrëveshje, minimalisht:

i. kopje të dokumentit të tij të udhëtimit, me të cilin ka hyrë në Republikën e Shqipërisë;

ii. kopje të marrëveshjes në të cilën përcaktohen detyrime specifike për pajisjen me leje qëndrimi;

iii. dokument që provon qëndrimin/banimin në Republikën e Shqipërisë;

iv. kërkesën nga institucioni i interesuar për pajisjen me leje qëndrimi.

6. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që kërkojnë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë vlerëson rastet e ndryshme nga ato të parashikuara në këtë vendim dhe autorizon autoritetin vendor për kufirin dhe migracionin për trajtimin e këtyre rasteve në përputhje me parashikimet ligjore.".

4. Në kreun IV, "Dispozita të fundit dhe kalimtare", bëhen këto ndryshime:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1 Pas prodhimit dhe vënies në qarkullim të modelit të vizës pullë dhe të kartës biometrike leje qëndrimi për të huajt, leja e qëndrimit provizore dhe leja e qëndrimit tipi A do të lëshohet sipas modelit dhe specifikimeve teknike, sipas anekseve 6/1 e 6/2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.".

b) Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

i. fjalët "... në nenin 104 ..." zëvendësohen me "... në nenin 145 ...";

ii. aneksi nr. 9 zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 6/1
SPECIFIKIME TEKNIKE PËR DOKUMENTIN "LEJE QËNDRIMI PËR SHTETAS TË HUAJ"
(PROVIZORE OSE TIPI A)

- Leja e qëndrimit (provizore /tipi A) për shtetasit e huaj do të jetë letër në përmasat 210X297 (format A4);
- Pesha specifike e letrës që do të përdoret për leje kalimi do të jetë 100–120 gr/m^2;
- Dokumenti "Leje qëndrimi" provizore ose tipi A do të përmbajë këto elemente sigurie:
- Shtyp me bojë të padukshme (të dukshme vetëm nën veprimin e dritës UV);
- Numri i serisë 7-shifror me bojë fluoreshente;
- Leja e qëndrimit për të huajt do të ketë përmbajtjen si formati në vijim.

ANEKSI 6/2

Nr._____ NS._____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT
RESIDENCE PERMIT OF THE ALIEN

TIPI _____
Type

Foto
Photograph

EMRI/AT, MBIEMRI _____
First name(s), Family name

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA **dd.mm.yyyy**
Place of birth *Date of birth*

DOKUMENTI UDHËTIMIT _____
Travel document

SHTETËSIA _____ GJINIA ___ GJENDJA CIVILE _____
Nationality *Sex* *Civil Status*

MOTIVI I QËNDRIMIT _____
Purpose of Stay

ADRESA NË SHQIPËRI _____
Address in Albania

Kjo leje qëndrimi është e vlefshme nga data **dd.mm.vvvv** deri në datën **dd.mm.vvvv**.
This residence permit is valid from *until*

DREJTORI

_____
Nënshkrimi, vula e autoritetit

ANEKSI 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin
Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit

Nr. 00000000000

Nr. regj. _____

_____, më ___.___.20___

PROCESVERBAL I KONSTATIMIT TË KUNDËRVAJTJES
RECORD OF FINDING OF THE OFFENCE

Data, vendi, konstatuesi Date, place, authority,	Sot, më ____. _____. _____, ora _____, në vendin _____, Today on *data/date muaji/month viti/year* *at* *at the place* *shkruhet emri i plotë i vendit / write full denomination of the place* Unë _____, me detyrë _____, I *grada, emri, mbiemri i punonjësit të policisë / rank, first name, family name of police employee* in the position of *funksioni/ function* Konstatova se: _____ found
Kundërvajtësi Offender	_____ *emri i plotë, atësia, mbiemri i kundërvajtësit / first name, father's name, family name of the offender* Pasaportë nr. _____, lëshuar në: _____ Passport no. issued on: Adresa në Republikën e Shqipërisë _____ Address in the Republic of Albania _____ *adresa e plotë e kundërvajtësit / full address of the offender*
Shkelja e konstatuar Found violation	Ka shkelur ligjin nr. _____, datë _____, "_____", Has violated law no. of neni ___, pika ____, shkronja _____: article paragraph letter _____: _____ _____ *Write the law reference for the found violation and a description of the offence*
Deklaratë Statement	Kundërvajtësi deklaron/Offender states: _____ _____

Për shkaqet e sipërshënuara, vendosa/Considering the foregoing reasons, I decided:

SANKSIONI: Të gjobitet me _____ (_____) lekë.
SANCTION: Imposition of a fine All.

KUNDËRVAJTËSI/OFFENDER

_____
Emri, mbiemri i kundërvajtësit / First name, family name of the offender

U PËRPILUA NGA/ RECORD PREPARED BY

_____
Grada, emri, mbiemri i punonjësit të policisë/ Rank, first name, family name of the police employee

Shënim. *Pagesa për kundërvajtjen mund të bëhet menjëherë ose në numrin e llogarisë sipas fishës bashkëlidhur.*
Note: *The fine related to the offence may be paid immediately or to the bank account number in the attachment herewith.*

VENDIM
Nr. 570, datë 3.10.2018

PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE AKSIONARE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, dhe të kreut III, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore, që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, të jetë:

a) Tre, për shoqëritë jostrategjike, të vogla e të mesme;

b) Gjashtë, për shoqëritë e sektorëve strategjikë me rëndësi të veçantë.

2. Anëtarët e këtyre këshillave propozohen si më poshtë vijon:

a) 2/3 e numrit të anëtarëve propozohen nga përfaqësuesi i pronarit, për pronën shtetërore;

b) 1/3 e numrit të anëtarëve propozohen nga ministri i linjës administrative apo organi i vetëqeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin, për shoqëritë shtetërore përkatëse.

3. Anëtarët e këshillave mbikëqyrës emërohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë dhe i njëjti person nuk mund të marrë pjesë në më shumë se 2 (dy) këshilla mbikëqyrës.

4. Në përbërje të këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore mund të përzgjidhen:

a) Nëpunës të institucioneve shtetërore, kur legjislacioni në fuqi nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera;

b) Specialistë të institucioneve kërkimore e shkencore, të universiteteve, me vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet dhe personat që gëzojnë autoritet profesional në fusha të caktuara;

c) Njëri nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të jetë specialist në fushën e ekonomisë dhe të financës.

5. Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës punonjës të organeve qendrore a vendore që kryejnë funksione auditimi, punonjës të emëruar si administratorë të shoqërive tregtare, drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare dhe kushdo tjetër, që ka konflikt interesash, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

6. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës, si më poshtë vijon:

a) Në shoqëritë aksionare shtetërore strategjike, për kryetarin, në masën 30 për qind të pagës mujore të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ndërsa, për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page;

b) Në shoqëritë aksionare shtetërore jostrategjike kombëtare, për kryetarin, në masën 30 për qind të pagës mujore të drejtorit të Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore në ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe, për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page;

c) Në shoqëritë aksionare shtetërore jostrategjike vendore, për kryetarin, në masën 30 për qind të pagës mujore të sekretarit të përgjithshëm të prefekturës dhe, për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page.

Për efekt të këtij vendimi, paga mujore përfshin pagën për funksion dhe pagën e grupit.

7. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime.

8. Në mbledhjen e tij të parë këshilli mbikëqyrës cakton sekretarin, i cili mund të jetë përfaqësues i pronarit ose i shoqërisë, si dhe masën e shpërblimit të tij. Masa e shpërblimit të sekretarit të këshillit mbikëqyrës në shoqëritë strategjike të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, në shoqëritë jostrategjike kombëtare të jetë 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj dhe në shoqëritë jostrategjike vendore 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

9. Këshilli mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe u raporton, për veprimtarinë

ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, jo më pak se 4 (katër) herë në vit.

10. Këtij vendimi nuk u nënshtrohen shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të akteve të veçanta nënligjore.

11. Vendimi nr. 642, datë 11.10.2005, i Këshillit të Ministrave, "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore", si dhe udhëzimi nr. 318, datë 8.4.2009, i ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore", shfuqizohen.

12. Ngarkohen ministria përgjegjëse për ekonominë, ministritë e linjës, organet e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë aksionare shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 571, datë 3.10.2018

PËR KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË BAZËS SË VLERËSUAR PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, paragrafi i dytë, e 59, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve, me datë fillimi 1.1.2018 dhe në vazhdim, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijojnë:

Për pagat referuese deri më 1.1.1994	8.76;
Për pagat e vitit 1994	8.76;
Për pagat e vitit 1995	7.05;
Për pagat e vitit 1996	5.47;
Për pagat e vitit 1997	5.47;
Për pagat e vitit 1998	4.57;
Për pagat e vitit 1999	3.71;
Për pagat e vitit 2000	3.38;
Për pagat e vitit 2001	2.89;
Për pagat e vitit 2002	2.67;
Për pagat e vitit 2003	2.39;
Për pagat e vitit 2004	2.17;
Për pagat e vitit 2005	1.97;
Për pagat e vitit 2006	1.79;
Për pagat e vitit 2007	1.71;
Për pagat e vitit 2008	1.51;
Për pagat e vitit 2009	1.39;
Për pagat e vitit 2010	1.33;
Për pagat e vitit 2011	1.28;
Për pagat e vitit 2012	1.23;
Për pagat e vitit 2013	1.18;
Për pagat e vitit 2014	1.18;
Për pagat e vitit 2015	1.02;
Për pagat e vitit 2016	1.02;
Për pagat e vitit 2017	1.00;
Për pagat e vitit 2018	1.00.

2. Në vitin 2018, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2017, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të jenë më të larta se:

a) Trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001;

b) Paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2018 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 927, datë 29.12.2014,

të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.12.2017, përfshirë edhe këtë datë.

5. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 572, datë 3.10.2018

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BRENDA PROGRAMEVE BUXHETORE TË BUXHETIT TË VITIT 2018, MIRATUAR PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin vitit 2018, miratuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, bëhet rishpërndarja e fondeve si më poshtë vijon:

a) Në programin "Programe zhvillimi", në zërin "Shpenzime kapitale të brendshme", shtohet fondi prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh;

b) Në programin "Infrastruktura vendore dhe rajonale", në zërin "Shpenzime kapitale të brendshme", pakësohet fondi prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 573, datë 3.10.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE MBIKËQYRËSE NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ENERGJINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 100, pika 1, e 116, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është:

- Përcaktimi i rregullave dhe procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror në ministrinë përgjegjëse për energjinë, në përmbushje të detyrimit për të garantuar ndërtimin, përdorimin e sigurt dhe respektimin e rregullave teknike përkatëse të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror dhe lidhjen e saj në kuadër rajonal;
- Garantimi i një furnizimi të qëndrueshëm e të sigurt me gaz natyror, nëpërmjet një tregu konkurrues dhe të liberalizuar;
- Mbështetja dhe mbrojtja e mjedisit, duke aplikuar vlerësime e procedura të njëjta për të licencuarit dhe operatorët e tjerë në sektorin e gazit natyror, përfshirë edhe linjat direkte, në rastet e vendosjes së penaliteteve për shkelje të mundshme të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me zbatimin dhe respektimin e rregullave e të standardeve teknike në shfrytëzimin e infrastrukturës dhe të instalimeve të gazit.

II. Përcaktimi i rolit të ministrisë në realizimin e mbikëqyrjes e të inspektimit në aktivitetet, instalimet dhe pajisjet e sektorit të gazit natyror

1. Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", në aktivitetet, instalimet dhe pajisjet e sektorit të gazit natyror kryhet nga ministria përgjegjëse për energjinë, me përjashtim të akteve dhe kompetencave rregullatore të Entit Rregullator të Energjisë.

2. Ministria e realizon funksionin e saj mbikëqyrës nëpërmjet strukturave të saj përgjegjëse për sektorin e gazit, që janë: struktura që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit në ministri dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin.

Marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit në ministri, dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.

3. Ministria mbikëqyr zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", për sa u përket zbatimit të rregullave teknike, procedurave, kushteve e standardeve në fuqi në aktivitetet për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës, të instalimeve e pajisjeve të sektorit të gazit, të cilat realizohen nga shoqëritë që kryejnë veprimtari në sektorin e gazit natyror.

4. Inspektimi, në funksion të mbikëqyrjes në aktivitetet e ndërtimit e të operimit të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, që kryhen nga shoqëritë e gazit natyror, për zbatimin e rregullave teknike dhe të procedurave përkatëse, specifikimeve teknike dhe normave të cilësisë, realizohet jo më shpesh se një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ka informacion për situata që paraqesin rrezikshmëri për pajisjet e instalimet dhe për jetën e njerëzve e të pronës së tyre.

5. Aktivitetet e mbikëqyrjes dhe të inspektimit në sektorin e gazit natyror mund të kryhen vetëm nga persona që kanë arsimin përkatës, janë të pajisur me certifikatën e lejes profesionale përkatëse, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure", dhe disponojnë kartën e identifikimit si punonjës të ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë apo të inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror.

6. Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë përcakton formën dhe përmbajtjen e certifikatës së lejes profesionale përkatëse, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure", si dhe miraton kartën e identifikimit për inspektorin që kryen inspektim në sektorin e gazit.

III. Mbikëqyrja dhe inspektimi në ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, si dhe në operatorët që kryejnë veprimtari në sektorin e gazit natyror

1. Mbikëqyrja dhe inspektimi mbulojnë zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", rregulloret, rregullat teknike dhe procedurat përkatëse, të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e aktivitetit të gazit:, projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e objekteve të gazit, të pajisjeve e linjave, përfshirë edhe linjat direkte, si dhe mbikëqyrjen e cilësisë së gazit të shpërndarë për konsumatorët.

2. Ministria do të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në operatorin e transmetimit të gazit natyror për përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Përcaktimin e kushteve tekniko-teknologjike për lidhjen e objekteve të transportit të gazit, të pajisjeve dhe impianteve;

b) Hermetizimin dhe mbajtjen e presionit të gazit natyror;

c) Operimin e sistemit të transportit të gazit natyror;

ç) Koordinimin e operacioneve në terren, mbi bazën e një rregulloreje të miratuar nga ministri;

d) Monitorimin e disponueshmërisë teknike e funksionale të transportit, duke përfshirë programin kohor për modernizimin e sistemit të transportit;

dh) Sigurimin e sistemit të transportit për dëmet që mund të shkaktohen në palët e treta;

e) Përdorimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të monitorimit e të operimit të sistemit të gazit natyror, në zbatim të rregullave dhe standardeve në fuqi;

ë) Kryerjen e kontrollit teknik në instalimet e transmetimit, në përputhje me rregullat teknike dhe Kodin e Rrjetit, që u referohet ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të instalimeve.

3. Ministria do të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në operatorin e shpërndarjes së gazit natyror për përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Përcaktimin e kushteve teknikо-teknologjike për lidhjen e objekteve të shpërndarjes së gazit, të pajisjeve dhe impianteve;

b) Hermetizimin dhe mbajtjen e presionit të gazit;

c) Operimin e sistemit të shpërndarjes së gazit natyror;

ç) Respektimin e parimit të transparencës dhe mungesës së diskriminimit në sistemet e tubacioneve dhe sistemit të informacionit në infrastrukturën e shpërndarjes së gazit natyror;

d) Shpërndarjen e sigurt të gazit natyror;

dh) Funksionimin, mirëmbajtjen dhe modernizimin e sistemit të shpërndarjes;

e) Zbatimin e rregullave e të standardeve në veprimtarinë që kryen;

ë) Kryerjen e kontrollit teknik në instalimet e shpërndarjes, në përputhje me rregullat teknike dhe Kodin e Rrjetit, që u referohet ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të instalimeve.

4. Ministria do të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në operatorin e magazinimit të gazit natyror për përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Presionin dhe kontrollin e sasisë në dy ciklet e punës;

b) Funksionimin e magazinave të gazit natyror;

c) Koordinimin e operacioneve në terren me operatorin e sistemit të transportit;

ç) Monitorimin dhe sigurimin e disponueshmërisë funksionale të sipërfaqes dhe pjesës nëntokësore të ruajtjes së gazit;

d) Respektimin e kodit në operacionet për qasjen e palëve të treta në kapacitetet magazinuese;

dh) Shfrytëzimin racional të kapacitetit magazinues;

e) Kryerjen e kontrollit teknik në depozitat e magazinimit nëntokësor të gazit natyror, në përputhje me rregullat teknike që u referohen ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të instalimeve.

5. Ministria do të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në operatorin e terminalit të gazit natyror të lëngëzuar për përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Funksionimin e depozitave e të instalimeve të ngarkim-shkarkimit dhe gazifikimit të gazit natyror të lëngëzuar;

b) Presionin dhe kontrollin e sasisë në dy ciklet e punës;

c) Koordinimin e operacioneve në terren me operatorin e sistemit të transportit;

ç) Monitorimin dhe sigurimin e disponueshmërisë funksionale të depozitave dhe infrastrukturës bregdetare të ngarkimit e shkarkimit të gazit natyror të lëngëzuar;

d) Respektimin e kodit në operacionet për qasjen e palëve të treta në kapacitetet depozituese dhe të ngarkim-shkarkimit;

dh) Shfrytëzimin racional të kapacitetit të terminalit të gazit natyror të lëngëzuar;

e) Kryerjen e kontrollit teknik në terminalin dhe instalimet bregdetare të gazit natyror të lëngëzuar, në përputhje me rregullat teknike që u referohen ndërtimit, mirëmbajtjes e përdorimit të terminalit dhe instalimet bregdetare të gazit natyror të lëngëzuar.

IV. Procedurat në realizimin e funksionit mbikëqyrës të ministrisë dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror

1. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, ministria dhe/ose inspektorati shtetëror përgjegjës për gazin, nëpërmjet kryeinspektorit, zbatojnë procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

2. Në rastet kur parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara, që janë identifikuar gjatë mbikëqyrjes së shoqërive që kryejnë veprimtari gazi të rregulluara, nuk janë eliminuar brenda afatit të përcaktuar, ministria i kërkon Entit Rregullator të Energjisë që të fillojë procedurën për heqjen e licencës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

3. Ministri, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, urdhëron kryerjen e inspektimeve të kombinuara, në rastet kur:

a) Është e nevojshme për të eliminuar një rrezik të menjëhershëm për jetën, shëndetin dhe pronën e qytetarëve;

b) Është e nevojshme të merren masa urgjente, që nuk mund të shtyhen;

c) Është e nevojshme, për shkak të kompleksitetit të mbikëqyrjes apo për rëndësinë e eliminimit të defekteve;

ç) Është e nevojshme për të kryer auditimin e shoqërive të gazit;

d) Konsiderohet se mbikëqyrja e kombinuar mund të kryhet më shpejt dhe me kosto më të ulët për të dyja palët, që janë subjekt i mbikëqyrjes dhe i kontrollit të inspektorëve;

dh) Është e nevojshme që të rishqyrtohen përfundimet e një inspektimi apo çdo nisme ose

ankese të bërë për çështje që janë në kompetencë të autoriteteve të inspektimit.

V. Roli dhe përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për sektorin e gazit në ministri në mbikëqyrjen dhe inspektimin e ndërtimit e të operimit të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, si dhe të subjekteve që kryejnë aktivitet në sektorin e gazit natyror

1. Struktura përgjegjëse për sektorin e gazit në ministri kryen mbikëqyrje në subjektet dhe personat që kanë të bëjnë me kryerjen e aktivitetit të gazit: projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e objekteve të gazit, të pajisjeve e linjave, përfshirë edhe linjat direkte, si dhe mbikëqyrjen e cilësisë së gazit të shpërndarë për konsumatorët, në lidhje me zbatimin e rregulloreve e akteve, për rregullat teknike dhe procedurat përkatëse në objektet dhe instalimet që shërbejnë për transportin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi dhe rregulloret përkatëse, të miratuara nga organet përkatëse, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

2. Objekti i mbikëqyrjes dhe inspektimit përfshin zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë vendim, në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", aktet nënligjore, rregullat teknike dhe procedurat përkatëse, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, si dhe specifikimet teknike dhe normat e cilësisë, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit.

3. Gjatë mbikëqyrjes, nëpunësit shtetërorë të njësisë përgjegjëse për sektorin e gazit, për kryerjen e detyrave të caktuara, mund të angazhojnë ekspertë nga organet dhe institucionet që kanë kualifikimin dhe eksperiencën e duhur në aktivitetin për projektimin, ndërtimin dhe operimin e linjave e të instalimeve të sektorit të gazit natyror.

VI. Roli dhe përgjegjësitë e inspektoratit shtetëror, përgjegjës për sektorin e gazit, nën mbikëqyrjen dhe inspektimin e ndërtimit e të operimit të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, si dhe të subjekteve që kryejnë aktivitet në sektorin e gazit natyror

1. Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit kryen inspektimin e objekteve për transportin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, nëpërmjet lëshimit të një urdhri inspektimi dhe në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe të rregullores së miratuar nga ministri.

2. Objekti i këtij inspektimi përfshin zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë vendim, të akteve nënligjore për rregullat teknike përkatëse, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit.

3. Kushtet, procedurat për vendosjen e gjobave dhe masa konkrete për çdo shkelje zbatohen në përputhje me pikën 3, të nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri.

4. Gjatë inspektimit, inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, për kryerjen e detyrave të caktuara mund të angazhojë ekspertë nga organet dhe institucionet e tjera, që kanë kualifikimin dhe eksperiencën e duhur në aktivitetin për projektimin, ndërtimin dhe operimin e linjave e të instalimeve të sektorit të gazit natyror.

VII. Të drejtat dhe detyrimet e inspektorit për inspektim në sektorin e gazit natyror

1. Inspektori në sektorin e gazit kryen inspektim të objekteve për transportin, shpërndarjen dhe depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar e të objekteve të tjera të gazit natyror, në përputhje me autoritetin që u jepet sipas ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

2. Inspektori për sektorin e gazit natyror kryen, gjithashtu, inspektimin e objekteve e të instalimeve të sektorit të gazit, në rastet e parashikuara nga ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe nga ky vendim.

3. Inspektori për sektorin e gazit natyror ka të drejtë dhe është i detyruar që, në proceset dhe aktivitetet e këtij sektori të inspektojë:

a) Nëse leja e ndërtimit dhe e operimit të infrastrukturës së gazit natyror është marrë në pajtim me nenin 11, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror";

b) Nëse miratimi i organit përkatës për punimet ndërtimore është përfituar në përputhje me legjislacionin për objektet e ndërtimit;

c) Nëse është përgatitur dokumentacioni teknik për vendosjen e pajisjeve dhe instalimeve të gazit;

ç) Nëse instalimi dhe testimi i pajisjeve të gazit është kryer në përputhje me ligjin dhe rregullat teknike përkatëse;

d) Nëse subjektet në sektorin e gazit, në funksionimin e tyre, plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", në lidhje me kryerjen e këtyre veprimtarive;

dh) Nëse instalimet në sektorin e gazit mbahen brenda parametrave teknikë gjatë funksionimit të tyre dhe janë të kontrolluara rregullisht e të testuara në përputhje me rregullat teknike dhe standardet;

e) Nëse personat që veprojnë në instalimet e gazit dhe personat që punojnë në mirëmbajtjen e tyre plotësojnë kushtet e përcaktuara për këto veprimtari dhe kanë dëshmitë përkatëse;

ë) Nëse cilësia e gazit natyror të furnizuar është në përputhje me standardet e miratuara.

4. Inspektori nuk mund të marrë pjesë në përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe në kryerjen e kontrollit teknik të dokumentacionit teknik për objektet, për të cilat ai/ajo është përgjegjës për kryerjen e inspektimit, nuk mund të marrë pjesë në punimet në objektet në të cilat ai/ajo do të kryejë inspektime dhe nuk mund të kryejë mbikëqyrjen e ekspertëve për veprat në objektet në të cilat ai/ajo kryen inspektimin.

VIII. Autorizimi i inspektimeve

Autorizimi i inspektimeve për mbikëqyrjen dhe inspektimin e aktiviteteve të ndërtimit e të operimit të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, si dhe të subjekteve që operojnë në sektorin e gazit natyror realizohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të këtij vendimi.

IX. Detyrimet e subjekteve që ndërtojnë e shfrytëzojnë infrastrukturën në sektorin e gazit natyror dhe janë operatorë në transmetimin, shpërndarjen e depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe në terminalet e gazit natyror të lëngëzuar

1. Subjekti, që kryen veprimtari të gazit natyror dhe/ose çdo person tjetër juridik në aktivitetet e gazit natyror është i detyruar të sigurojë mbikëqyrje dhe inspektim të papenguar për përfaqësuesit e strukturës së gazit në ministri apo të inspektorëve të inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin, t'i lejojë atë/ata për të hyrë në objektet dhe t'u vërë në dispozicion të gjitha informatat e nevojshme, dokumentet dhe raportet e nevojshme për realizimin e mbikëqyrjes e të inspektimit.

2. Subjektet që kryejnë veprimtari të gazit dhe përdoruesit e sistemit të gazit janë të detyruar të veprojnë sipas kërkesës apo urdhrit të lëshuar nga autoriteti inspektues, i përcaktuar në kreun VI të këtij vendimi dhe, në veçanti, duhet:

a) Të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes dhe inspektimit;

b) Të sigurojnë informacion për dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për mbikëqyrjen;

c) Të sigurojnë kushtet e nevojshme për përcaktim të gjendjes faktike;

ç) Të mundësojnë, në afatin e përcaktuar, aksesin në objektet, produktet ose çfarëdo dokumentesh të tjera, që janë objekt i inspektimit;

d) Të ndërpresin veprimtarinë gjatë mbikëqyrjes apo inspektimit, në bazë të kërkesës me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës apo inspektues, vetëm kur, sipas të dhënave korrente që disponohen, instalimet e gazit rezultojnë jo brenda parametrave teknikë të operimit të sigurt gjatë funksionimit të tyre, me qëllim kryerjen e mbikëqyrjes apo inspektimit dhe përcaktimin e gjendjes faktike;

dh) T'i paraqesin inspektorit ose të përgatisin të dhëna të sakta e të plota, raporte, materiale apo dokumente të tjera të nevojshme, me qëllim kryerjen e inspektimit, bazuar në kërkesën me shkrim dhe brenda një afati të përcaktuar në kërkesën e organit të inspektimit.

3. Subjekti që kryen veprimtari të gazit natyror, një person juridik dhe sipërmarrës, që është udhëzuar me vendim të inspektorit të mënjanojë të metat dhe parregullsitë, do të jetë i detyruar të informojë me shkrim inspektorin rreth korrigjimit të defekteve dhe parregullsive brenda afatit të specifikuar në vendim.

X. Procedimi, në rast moszbatimi të kërkesave ligjore

1. Nëse inspektori nga inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, gjatë kryerjes së inspektimit identifikon se dispozitat e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të këtij vendimi, të rregulloreve të tjera, rregullave, standardeve, specifikimeve teknike dhe normave të cilësisë nuk kanë qenë në përputhje me përcaktimet dhe vlerat përkatëse ose janë zbatuar në mënyrë të papërshtatshme, miraton një vendim, me anë të të cilit:

a) Urdhëron riparimin e mangësive të identifikuara, të cilat ndikojnë negativisht në funksionimin e impianteve e të pajisjeve dhe përcakton afatin për këtë riparim;

b) Ndalon përdorimin e objektit, të impiantit, pajisjes ose instalimit, kur subjekti nuk ka arritur të riparojë parregullsitë e identifikuara brenda afatit të caktuar;

